



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KUSHTETUESE

УСТАВНИ СУД

CONSTITUTIONAL COURT

SEKRETARIA / SEKRETARIJAT / SECRETARIAT

Datë: 05 shtator 2011

Në mbështetje të nenit 12 dhe 13 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës Nr. 03/L-121, dhe të nenit 18 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Sekretaria shpall:

KONKURS

Për plotësimin e vendit të punës:

1. Këshilltar Juridik (3)

1.

Pozita: Këshilltar Juridik

Kodi: GJ 02-06

Numri i vendeve të punës: 3 (tre)

Kohëzgjatja e kontratës: Tre (3) vjet me mundësi vazhdimi

Puna Provuere: Tre (3) muaj

Përshkrimi i Përgjithshëm i Pozitës: Nën mbikëqyrje të Këshilltarit të Parë Juridik dhe gjyqtarëve përkatës mbështet punën profesionale të gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese duke bërë hulumtime ligjore dhe analiza dhe duke ndihmuar në hartimin e vendimeve, raporteve dhe materialeve të tjera juridike të hartuara nga Gjykata Kushtetuese.

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:

- Jep këshilla për çështje të ndërlikuara juridike;
- Bën analiza për çështje të ndërlikuara juridike;
- Mbështetë gjyqtarët në hartimin e vendimeve, raporteve, materialeve të tjera juridike të hartuara nga Gjykata Kushtetuese
- Kryen punë të tjera profesionale sipas kërkesës së Këshilltarit të Parë Juridik dhe gjyqtarëve përkatës.

Kualifikimet minimale dhe përvoja e përgjithshme:

- Përgatitje superiore shkollore në shkencat juridike, preferohen trajnime ose specializime në të drejtën kushtetuese, të drejtat e njeriut, të drejtën ndërkombëtare publike apo drejtim tjetër të së drejtës publike;
- Së paku dy (2) vite përvojë përkatëse profesionale në çështjet juridike;
- Të jetë person me integritet të lartë personal dhe moral.

Kandidati për pozitën e Këshilltarit Juridik duhet të posedojë njohuri të thella profesionale, si dhe aftësi të shkëlqyeshme hulumtuese, analitike dhe organizative. Preferohet të ketë provimin e Jurisprudences si dhe përvojë në gjyqësi.

Po ashtu, Kandidati duhet të demonstrojë qasje pragmatike në gjetjen e zgjidhjeve adekuate me burime të kufizuara, të ketë aftësi të zhvilluara komunikimi (në mënyrë verbale dhe me

shkrim), të ketë aftësi për të identifikuar prioritetet, të ketë aftësi për të bashkëvepruar me maturi dhe ndjeshmëri me kolegë dhe palë; të ketë aftësi për të punuar në mënyrë efikase nën presion kohor; të ketë aftësi për të trajtuar informatat e besueshme në mënyrë të duhur; të ketë aftësi të shkëlqyeshme në përdorimin e kompjuterit, dhe hulumtimit në internet.

Kandidati duhet të njohë gjuhën shqipe dhe serbe, si dhe të ketë njohuri të shkëlqyeshme të gjuhës angleze në të folur dhe në të shkruar.

Informata të Përgjithshme për Kandidatë

Përcaktimi i pagës, për pozitën e shpallur, bëhet në përputhje me Rregulloren e Punës dhe Vendimin e Gjykatës Kushtetuese lidhur me klasifikimin e pozitave, pagave, shtesave dhe mëditjeve në Gjykatën Kushtetuese.

Gjykata Kushtetuese ofron mundësi të barabarta punësimi dhe mirëpret aplikacionet nga personat e komuniteteve jo shumicë dhe nga kandidatët femra. Politika e përfaqësimit gjinor dhe të të gjitha komuniteteve të Kosovës do të zbatohet gjatë procesit të punësimit në Sekretarinë e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

Procedura e Konkurrimit

Kandidatët e interesuar duhet të paraqesin aplikacionin përkatës, të shoqëruar nga një biografi profesionale, një letër motivuese dhe dokumentacioni përkatës lidhur me përgatitjet shkollore dhe përvojën e kërkuar të punës. Forma e aplikacionit mund të shkarkohet nga ueb faqja e Gjykatës Kushtetuese www.gjk-ks.org

Aplikacioni me të gjitha dokumentet duhet të paraqitet nëpërmjet e-mailit në adresën resmije.losi@ks-gov.net.

Data e fundit për pranimin e aplikacioneve është **20.9.2011, në orën 24:00.**

Aplikacionet e dërguara me vonesë nuk do të merren në konsiderim.